

dhe dy bashkëfshatarë të tjerë, pjesëtarë të UÇK-së. Që të gjithë së bashku u nisën për Radishevë/Radiševo. Në afërsi të vendit të quajtur *Te Ara e Sylës/Sylina njiva* [Radishevë/Radiševo], ata u ndeshën me forcat serbe. Faiku dhe Beqiri kanë rënë gjatë shkëmbimit të zjarrit, përderisa për Sabitin dhe Azemin nuk dihej asgjë deri më 4.08.1998, kur ushtarët e UÇK-së i kanë gjetur trupat e tyre të pajetë pak më larg vendit ku u vranë Faiku dhe Beqiri. Që të gjithë u varrosën në ditën e njëjtë *Te ara e Sylës/Sylina njiva*. Pas përfundimit të luftës, më 12.11.1999, ata u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Polac/Poljance.

Burimet: deklarata P.H, FDH-32802; deklarata A.T, FDH-32801; deklarata S.S, FDH-6780; deklarata V.T, FDH-18998; J. Martinsen, *Regjistrri..*, FDH-26092; *Serb Forces Embark on Large-Scale Attack in Drenica*, pasqyra e lajmeve, KIC, 27.07.1998, FDH-29378.

Feriz (Ramiz) Selimi

(25.11.1945, shqiptar nga Radisheva/Radiševo, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, tetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Ferizi me bashkëshorten, tetë fëmijë dhe vëllain Bislimin me familje jetonin në *Mëhallën Ramizaj* [Radishevë/Radiševo]. Vëllezërit merreshin me bujqësi. Ferizi aderoi në UÇK më 20.04.1998. Kur filluan luftimet në fshat më 25.07.1998, Ferizi dhe Bislimi po ktheheshin nga mulliri në shtëpi me traktorin e ngarkuar me miell. Shpejt i nxorën familjet nga fshati dhe i çuan në Çubrel/Çubrelj. Kur ka rënë teri i natës, ata u kthyen në fshat. Të nesërmen, më 26.07.1998, Ferizi ka rënë në betejë, e cila u zhvillua në pyll në vendin e quajtur *Piskavica* [Radishevë/Radiševo]. Trupi i tij ka mbetur në vendin e vrasjes deri më 15.08.1998. Atë ditë, familjarët e kanë varrosur në të njëjtin vend ku ai ka rënë. Pas përfundimit të luftës, më 25.08.2000, mbejtjet e tij mortore u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në fshat.

Burimet: deklarata A.S, FDH-32467; deklarata S.S, FDH-6780; J. Martinsen, *Regjistrri..*, FDH-26092; deklarata V.T, FDH-18998; *Body of Albanian, Slaughtered By Serbs, Buried With Mis-*

sing Head, pasqyra e lajmeve, KIC, 11.08.1998, FDH-29429.

Azem (Istref) Miftari

(1.03.1963, shqiptar nga Runiku/Rudnik, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, dy fëmijë)

Në datën 19.07.1998, Azemi me familje e braktisën Runikun/Rudnik. Shkuan në Klladërnice/Kladernica, ku i ka pranuar Fatmir Smakaj. Shtatë ditë më vonë, më 26.07.1998, Azemi u nis në **Runik/Rudnik** për ta ushqyer bagëtinë. Nuk u kthye më. Pas një muaji, familja e tij u kthye në fshat. Nuk e gjetën Azemin. E kërkonin gjithandej, por nuk kishte kurrfarë gjurmësh të tij. Pas përfundimit të luftës, më 4.10.1999, ushtarët e UÇK-së e kanë gjetur letërnjoftimin e Azemit në *Mëhallën Prokshi*. E njoftuan familjen dhe djali i Azemit e ndërmori menjëherë një kërkim, gjatë së cilit e gjeti së pari këpucën e të atit, ndërkaq, më pas, edhe trupin e tij të karbonizuar. Po atë ditë, familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Azemit në varrezat e fshatit.

Burimi: deklarata V.M, FDH-15966.

Ali (Smajl) Muharremi

(1930, shqiptar nga Runiku/Rudnik, komuna e Skënderajt/Srbica, shtëpiak, gjashtë fëmijë)

Fanë (Rustem Zikolli)

Muharremi

(1936, shqiptare nga Runiku/Rudnik, komuna e Skënderajt/Srbica, gjashtë fëmijë)

Shtëpia e Aliut dhe Fanës në **Runik/Rudnik** ndodhej afro 50 metra larg nga stacioni policor. Aliu punonte si shtëpiak në shkollën fillore *Shotë Galica*, përderisa bashkëshortja kujdesej për shtëpinë e tyre deri në vitin 1996, kur u paralizua nga një sëmundje. Jetonin vetëm. Djemtë i kishin të punësuar jashtë vendit, ndërkaq vajzat i kishin të martuara. Kur banorët e fshatit i braktisën shtëpitë e veta për shkak të presionit të forcave serbe, ata vendosën që të rrinin në shtëpi. Vëllai i Aliut, Xhaferi, i cili jetonte në të njëjtin oborr, mundahej që t'i bindte që të niseshin me të, por ata nuk deshën t'i bëheshin barrë për shkak të